VENDIM
Nr.37, datë 15.4.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "DN& NAT ENERGJI" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a" nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, germa "a" të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a" dhe nenit 10, pikat 1, 3 dhe 4 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1, germa "a", të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 15.4.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "DN& NAT Energji" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "DN& NAT Energji" sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa "a", "b", "c", "d", "f" dhe "g") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa "a", "b", "c" dhe "d") janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Subjekti "DN& NAT Energji" sh.p.k., ka informuar se është në proces të marrjes së lejes mjedisore dhe të miratimit të pikës së lidhjes së kërkuar nga neni 9 pika 4.1.5 i rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", duke plotësuar kërkesën e nenit 8 pika 4 të kësaj rregulloreje.

Për gjithë sa më sipër, cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë "DN& NAT Energji" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec "Kumbull Merkurth".
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj